



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E LARTË  
KOLEGJI PENAL**

**Nr. 52704-01164-00-2016 Regj. Themeltar  
Nr. 00-2022- Vendimi**

**VENDIM**

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me trup gjykues të përbërë nga:

<b>Ilir PANDA</b>	<b>Kryesues</b>
<b>Albana BOKSI</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Medi BICI</b>	<b>Anëtar</b>

Në datë 09.06.2022, mori në shqyrtim në dhomë këshillimi çështjen penale me nr. 52704-1164-2016 akti, që i përket:

**KËRKUES:** Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë

**TË GJYKUAR:** 1- Ibrahim Xhafa  
2- Xhevdet Xhafa

**AKUZUAR:** Për kryerjen e veprës penale të “Trafikimi i personave të rritur”, kryer në bashkëpunim, në dëm të shtetases Engjëllushe Xhafa, të parashikuar nga neni 110/a/4 i Kodit Penal

**KOLEGJI PENAL I GJYKATËS SË LARTË**

pasi dëgjoi relatimin e gjyqtarës Albana Boksi dhe diskutoi çështjen në tërësi,

**V Ë R E N**

**I. Rrethanat e çështjes**

1. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë (në vijim prokuroria), më datë 24.11.2015, ka paraqitur kërkesë për gjykimin e të pandehurve Ibrahim Xhafa dhe Xhevdet Xhafa, duke ju atribuar kryerjen e veprës penale “Trafikimi i personave të rritur”, të kryer në bashkëpunim, të parashikuar nga neni 110/a/4 i Kodit Penal. Nga aktet dhe provat e shqyrtuara, rezulton që prokuroria ka regjistruar procedimin penal nr. 342, në datë 22.12.2014, mbi bazë të akteve hetimore të referuara nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Tiranë.

2. Drejtoria e Policisë së Qarkut Tiranë ka referuar në prokurori rastin e trafikimit të një personi të rritur, shtetases Engjëllushe Xhafa, e cila shfrytëzohej për lypje, duke përfituar nga gjendja e saj

fizike e mendore, rast ky i publikuar nga emisionit “Ça thu”, në datë 15.12.2014, në televizionin “Agon Chanel”. Nga ana e Prokurorisë janë kryer veprimet hetimore që ajo ka çmuar të nevojshme, duke arritur në përfundimin se shtetasja Engjëllushe Xhafa është trafikuar me qëllim shfrytëzimin e saj për lypje, nga vëllezërit, të pandehurit Ibrahim Xhafa dhe Xhevdet Xhafa. Në këto rrethana, prokurori ju ka komunikuar në përfundim të hetimeve, akuzën për kryerjen e veprës penale të: “Trafikimit të personave të rritur”, parashikuar nga neni 110 / a i Kodit Penal

3. Nga aktet e fashikullit të gjykimit ka rezultuar se, shtetasja Engjëllushe Xhafa, e datëlindjes 14.11.1980, është motra e dy të pandehurve dhe është me të aftësi të kufizuara fizike dhe mendore, ku, sipas aktit të ekspertimit psikiatriko-ligjor nr. 235, datë 14.7.2015 të Institutit të Mjekësisë Ligjore, Tiranë, *kjo shtetase prezanton probleme të zhvillimit intelektual dhe prezanton moshë mendore të një 13-14 vjeçar të paarsimuar.*

4. **Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, me vendimin nr. 43, datë 04.04.2016**, ka vendosur: “*“1. Deklarimin fajtor të të pandehurit Ibrahim Xhaferr Xhafa, për kryerjen e veprës penale të: “Keqtrajtimi i të miturit”, e kryer në bashkëpunim, e parashikuar nga neni 124/b paragrafi i dytë, e 25 të Kodit Penal, sipas ndryshimeve të bëra me ligjin nr. 144/2013 dhe dënimin e tij, në bazë të këtyre neneve me 5 (pesë) vjet burgim. 2. Deklarimin fajtor të të pandehurit Xhevdet Xhaferr Xhafa, për kryerjen e veprës penale të: “Keqtrajtimi i të miturit”, e kryer në bashkëpunim, e parashikuar nga neni 124/b, paragrafi i dytë, e 25 të Kodit Penal, sipas ndryshimeve të bëra me ligjin nr. 144/2013 dhe dënimin e tij, në bazë të këtyre neneve, me 4 (katër) vjet e 6 (gjashtë) muaj burgim. 3. Vuajta e dënimit për të pandehurit Ibrahim Xhaferr Xhafa dhe Xhevdet Xhaferr Xhafa, të fillojë nga data e arrestimit të tyre, datë 2.3.2015, dhe të bëhet në një burg të sigurisë së zakonshme”.*

5. Kundër këtij vendimi ka bërë ankim Prokuroria pranë Gjykatës për Krime të Rënda, si dhe dy të pandehurit. Prokuroria ka kërkuar: “*Ndryshimin e vendimit nr. 43, datë 04.04.2016, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë, duke vendosur përfundimisht: Deklarimin fajtor të të pandehurit Ibrahim Xhafa, për veprën penale të “Trafikimit të personave të rritur”, kryer në bashkëpunim, shoqëruar me detyrimin e të dëmtuarit për të lypur, të parashikuar nga neni 110/a/4 i Kodit Penal dhe e tij me 15 vjet burgim. Deklarimin fajtor të të pandehurit Xhevdet Xhafa, për veprën penale të “Trafikimit të personave të rritur”, kryer në bashkëpunim, shoqëruar me detyrimin e të dëmtuarit për të lypur, të parashikuar nga neni 110/a/4 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 15 vjet burgim”.*

5.1. Kundër vendimit të sipërcituar kanë paraqitur ankim edhe dy të pandehurit Ibrahim dhe Xhevdet Xhafa, nëpërmjet avokatit mbrojtës, duke kërkuar: “*Ndryshimin e vendimit nr. 43, datë 04.04.2016, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë, duke dhënë pafajësi për shtetasit Ibrahim Xhafa dhe Xhevdet Xhafa”.*

6. **Gjykata e Apelit për Krime të Rënda Tiranë, në vendimin nr. 54, datë 16.05.2016**, ka vendosur: “*Lënien në fuqi të vendimit Nr. 43, datë 04.04.2016 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë”*

7. **Kundër vendimit nr. 54, datë 16.05.2016 të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tiranë, ka paraqitur rekurs**, depozituar në datë 03.06.2016, Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda, e cila ka kërkuar: “*Ndryshimin e vendimit penal nr. 54 datë 16.05.2016 të Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda Tiranë për cilësimin juridik, deklarin faktor dhe dënimin e të pandehurve të sipërpërmendur, për veprën penale të “Trafikimit të personave të rritur”, të parashikuar nga neni 110/a i Kodit Penal”.* Në mënyrë të përmbledhur, në rekurs, prokuroria ka parashtruar këto shkaqe:

- Kundërshtimin tonë në lidhje me vendimmarrjen e gjykatave do ta përmbledhim në dy momentet kryesore, që përbëjnë thelbin e ndryshimit të akuzës. E para, ka të bëjë me mungesën e provave dhe e dyta, ka të bëjë me elementët përbërës të veprës penale të parashikuar nga neni 110/a të Kodit Penal, që sipas gjykatës nuk janë të pranishme në rastin objekt gjykimi.

- Vlerësimi dhe arsyetimi i gjykatës në lidhje me provat është i gabuar dhe në kundërshtim me përcaktimet e nenit 152 të Kodit të Procedurës Penale (KPP). Ndryshe nga sa ajo arsyeton provë nuk janë vetëm thëniet e të dëmtuarës në fazën e hetimeve paraprake, por edhe prova me dokument: si procesverbal për këqyrjen dhe transkriptimin e bisedave të kasetës filmike të datës 15.1.2015, në të cilën gjenden të pasqyruara bisedat e zhvilluara ndërmjet gazetarit të televizionit ‘Agon Channel’ dhe të pandehurit Ibrahim Xhafa, si dhe ato të zhvilluara ndërmjet shtetases Engjëllushe Xhafa dhe gazetares së këtij televizioni, të marra dhe të administruara sipas nenit 191 të KPP, apo dhe deklaratimet e vëllait të dëmtuarës dhe njëkohësisht të pandehurit shtetasit Lulëzim Xhafa, të datës 02.03.2015 administruar në kuadër të kundërshtimit të pjesshëm të dëshmisë.

- Deklarimet e të dëmtuarës Engjëllushe Xhafa, dhe të shtetasit Xhevdet Xhafa, e Lulëzim Xhafa, shërbejnë si provë konform nenit 362/3 i KPP, pasi ato lidhen dhe me provat e tjera, si: pamjet filmike, përgjimet dhe vëzhgimet e autorizuara apo provat me dokument, procesverbal për kryerjen dhe marrjen e provave materiale, i datës 2.11.2015, Libri i shërbimit në situata të emergjencave, e Komisarariatit të Policisë Kavajë apo procesverbal për kryerjen dhe marrjen e provave materiale i datës 2.11.2015, kartela mjekësore e Spitalit Kavajë etj, që në tërësinë e tyre konfirmojnë vërtetësinë e deklaratimeve.

- Provat që vërtetojnë faktin penal janë të plota dhe kjo pohohet më pas nga vetë gjykata, në mënyrë kontradiktore në pjesën në vazhdim të vendimit gjyqësor kur shprehet se, të gjitha provat e tjera, siç janë procesverbalet e vëzhgimit të kryera nga oficerët e policisë gjyqësore, në zbatim të autorizimit të prokurorit për përgjime në vende publike, procesverbalet e përgjimit të bisedave telefonike të zhvilluara nga të pandehurit Ibrahim Xhafa dhe Xhevdet Xhafa, si dhe të gjitha aktet dhe provat e tjera shkresore, në harmoni me njëra-tjetrën, provojnë që dy të pandehurit kanë bërë shtytjen dhe përdorimin e shtetases Engjëllushe Xhafa, për të lypur, me anë të transportimit të saj në vende të ndryshme, ku ajo ushtronte aktivitetin e lypjes dhe me anë të kthimit të saj në shtëpi, në përfundim të ditës, pasi ajo shtetase, kishte lypur në vende të ndryshme.

- Në lidhje me ndryshimin e cilësimit juridik të veprës, që ka të bëjë me atë që ajo e konsideron si mungesë elementit thelbësor të veprës penale të trafikimit të personave të rritur “rekrutimin e të dëmtuarës”. Në lidhje me këtë moment të vendimmarrjes së saj, gjykata është përpjekur të bëjë një zbërthim mjaft të gjerë të gjithë elementëve përbërës të veprës penale të parashikuar nga neni 110/a të KP, për të arritur në fund në konkluzionin e gabuar se ekzistenca e kësaj vepre penale është e lidhur pazgjidhshmërisht me elementin “rekretim”, në një kohë mjafton të lexohet përmbajta e kësaj dispozite për të arritur në konkluzionin se elementët përbërës të anës objektive të kësaj vepre penale përveç rekrutimit, janë edhe transportimi, e transferimi të cilët në një rast konkret, sikurse dhe praktika ka vërtetuar mund të qëndrojnë më vete, pra të shkëputur nga elementi rekrutim.

- Provohet që e dëmtuara është transportuar dhe transferuar në vende të ndryshme nga të pandehurit për të ushtruar aktivitetin e lypjes, edhe pse ky transportim është bërë brenda për brenda territorit të vendit, ashtu sikurse edhe dispozita e nenit 110/a të KP, e ka të parashikuar. Rezulton se gjykata ka zbatuar në mënyrë të gabuar ligjin penal, duke bërë ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale nga trafikim të rriturve në veprën penale të “Keqtrajtimit të të miturit”, parashikuar nga neni 124/b i KP.

- Problemi shtrohet në një rrafsh më të gjerë, nëse do të konsiderohet si trafikim sipas nenit 110/a të KP, transportimi dhe transferimi brenda për brenda territorit, apo nisur dhe nga titullimi i dispozitës, ky lloj transportimi duhet bërë në kuadër të një qëllimi final të nxjerrjes jashtë kufijve shtetëror? Për të bërë një zgjidhje përfundimtare të këtij problemi juridik, ne mendojmë se ndoshta është e nevojshme që nisur nga kjo çështje konkrete, rasti të mundësohet nga Kolegji Penal për tu zgjidhur nga Kolegjet e Bashkuara me qëllim interpretimin e saktë.

**8. Kundër vendimit nr. 54, datë 16.05.2016 të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tiranë, kanë paraqitur rekurs, depozituar në datë 16.06.2016 të gjykuarit Ibrahim Xhafa dhe Xhevdet**

Xhafa, të cilët kanë kërkuar: “*Ndryshimin e vendimit penal nr. 54 datë 16.05.2016 të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tiranë, për cilësimin juridik, duke dhënë pafajësi, për shtetasit Ibrahim Xhafa dhe Xhevdet Xhafa*”. Në mënyrë të përmbledhur, në rekurs të gjykuarit kanë parashtruar këto shkaqe:

- Nga analiza juridike e fakteve, rezulton se nuk është kryer asnjë nga veprat penale të parashikuara në Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë. Në dosjen gjyqësore është administruar certifikatë e lindjes e shtetasës Engjëllushe Xhafa, e cila rezulton se është e datëlindjes 14 nëntor 1980. Pra, është në moshë madhore biologjike dhe fizike 36 vjeçare, pra nuk kemi përpara veprës penale të parashikuar nga neni 124/b të KP, e cila lidhet me subjektin e mitur. Në këtë dispozitë, siç është parashikuar edhe në disa dispozita të tjera të Kodit Penal, nuk është barazuar në mbrojtje personi me paaftësi mendore apo fizike me të miturin.

- Nga të gjitha aktet në dosjen gjyqësore rezulton se shtetasja Engjëllushe Xhafa, pavarësisht se është me paaftësi fizike dhe mendore nuk garanton mbrojtje nga kjo dispozite. Shtytja e detyrueshme ose jo për punë, për lypësi e një personi me paaftësi mendore apo fizike, pavarësisht moralit, nuk është parashikuar si e kundërligjshme apo vepër penale në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë. Në këto rrethana, konstatohet se veprimet e dy të të pandehurve Ibrahim dhe Xhevdet Xhafa, nuk përmbajnë elementë të kundërligjshëm të parashikuar si vepra penale në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë.

- Në këto kushte, referuar edhe nenit 290/1 pika (c) dhe (ç) të KPP: “ Procedimi penal nuk mund të fillojë dhe, në qoftë se ka filluar, duhet të pushojë në çdo gjendje të procedimit, sepse: c) mungon ankimi i dëmtuarit; (në asnjë fletë të dosjes për procedimin penal nr. 342 të vitit 2014, të paraqitur për gjykim nga organi i akuzës, përpara gjykatës, nuk rezulton të ketë ndonjë ankesë nga e dëmtuara Engjëllushe Xhafa, ndaj të pandehurve Ibrahim dhe Xhevdet Xhafa; ç) kur fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale, ose kur del qartë, që fakti nuk ekziston.

- Lidhur me cilësimin e veprës penale si të kryer në bashkëpunim, në Kodin Penal, neni 28 nënvizohen format e veçanta të bashkëpunimit. Por shtytja e detyrueshme ose jo për punë për lypësi e një personi me paaftësi mendore apo fizike, nuk klasifikohet në asnjërën prej formave të bashkëpunimit, në vështrim të nenit të sipërcituar. Për të bërë një zgjidhje përfundimtare të këtij problem juridik, mendojmë se është e nevojshme që duke u nisur nga ky rast, i konsideruar nga apeli si rast “*sui generis*” kjo çështje konkrete (lypësia), të mundësohet nga Kolegji Penal për tu zgjidhur nga Kolegjet e Bashkuara, me qëllim për një interpretim të saktë dhe të qartë për rastin në fjalë dhe rastet e tjera të ngjashme.

## **II. Vlerësimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë**

9. Gjatë shqyrtimit të çështjes në dhomë këshillimi, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë (në vijim Kolegji) vlerëson se në rekursin e depozituara si nga prokuroria, ashtu edhe nga të gjykuarit, ngrihen çështje ligjore me rëndësi për njësimin dhe zhvillimin e praktikës gjyqësore, në vështrim të kërkesave të nenit 432 pika ‘1’, shkronja ‘a’ e KPP. Kolegji nga verifikimi i qëndrimit të mbajtur nga (ish) gjykatat për krime të rënda (shkallë e parë dhe apel) në rastin konkret, në raport me raste të tjera të ngjashme ku është janë trajtuar çështje të trafikimit të qenieve njerëzore (referuar këtu edhe qëndrimeve të Kolegjit Penal, veçanërisht qëndrimit unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në vendimin nr. 03/2011), vlerëson se ka qëndrime të ndryshme në lidhje me cilësimin juridik të faktit penal të trafikimit të personave, të rritur apo të mitur. Këto qëndrime janë ndikuar edhe nga vendimi unifikues i lartpërmendur, në të cilin është dhënë kuptimi i termit “trafikimit”, duke theksuar: “*Kështu, ligjvënësi, për rastet kur vepra ka karakter transnacional, ka përdorur në Kodin tonë Penal termin e përgjithshëm “trafikim” për titullimin e veprës (nenet 110/a, 114/b, 128/b, 138/a, 141/a, 278/a, 282/a dhe 283/a). Sipas legjislacionit tonë penal, pavarësisht nga personat e llojet e*

*mallrave që trafikohen dhe origjinën e tyre, në thelb, trafikimi nënkupton rastet kur veprimtaria e kundërligjshme, duke përfshirë Shqipërinë e territorin e saj, kryhet në më shumë se një shtet, kryhet në një shtet por është përgatitur, programuar, drejtuar e kontrolluar në një shtet tjetër, kryhet në një shtet por ka efekte e pasoja thelbësore në një shtet tjetër. Prandaj, Kolegjet e Bashkuara vijnë në përfundimin se, **kriter bazë për kuptimin e zbatimin e drejtë të veprave penale të “trafikimit” sipas Kodit tonë Penal është parimi i territorit, i prekjes e përdorimit të tij, me qëllimin e realizimit në rrugë kriminale të përfitimeve, përmes hyrjes ose daljes së paligjshme të personave apo sendeve nga territori shqiptar ose kalimit të paligjshëm të tyre nëpërmjet territorit shqiptar.***

## **PËR KËTO ARSYE**

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, mbështetur në nenin 438 të Kodit të Procedurës Penale,

### **V E N D O S I**

- Kalimin në seancë gjyqësore me trup gjykues prej 5 gjyqtarësh për shqyrtimin e çështjes penale me nr. 52704-1164-2016 datë 28.06.2016, me qëllim njësimin e praktikës gjyqësore në lidhje me çështjet:
  - 1- Cilat janë format e kryerjes së veprës penale të trafikimit të qenieve njerëzore?
  - 2- Veprat penale të parashikuara nga nenet 110/a dhe 128/b të Kodit penal, janë vepra penale formale apo materiale?
  - 3- Cili është kuptimi i termit ‘trafikim’ në rastin e trafikimit të qenieve njerëzore dhe çfarë duhet kuptuar me ‘trafikim të brendshëm’?
  - 4- Në rast se në kuptimin e termit trafikim, përfshihet edhe trafikimi i brendshëm i personave të rritur apo të mitur, cilat janë dallimet mes veprave penale ‘Trafikim i personave të rritur’ (neni 110/a i KP) dhe ‘Trafikim i të miturve’ (neni 128/b i KP), me veprat penale ‘Shfrytëzimi i prostitucionit’ (neni 114 i KP) dhe ‘Keqtrajtimi i të miturit’ (neni 124/b i KP)?
  - 5- Si duhet cilësuar fakti i shtytjes së detyrueshme ose jo, për punë apo për lypje e një personi me aftësi të kufizuara mendore apo fizike, kur ky person nuk është në moshë të mitur? A mund të trajtohet në këtë rast personi me aftësi të kufizuara mendore si një person që për nga zhvillimi mendor barazohet me një të mitur?
- Seanca gjyqësore caktohet për tu zhvilluar në datë 14.07.2022, ora 13:00.
- Urdhërohet sekretaria gjyqësore të njoftojë palët për ditën dhe orën e seancës gjyqësore të caktuar për njësimin e praktikës gjyqësore, si dhe t’ju komunikojë këtë vendim.

Tiranë, më 09.06.2022